

**PROCESVERBAL**  
**nga seanca e 13-të e Këshillit të Agjencisë për Shërbime**  
**Mediatike Audio dhe Audiovizuale**  
**mbajtur më 02.04.2024**

**Anëtarët e pranishëm të Këshillit të Agjencisë nëpërmjet lidhjes video-konferencë:** Lazo Petrushevski kryetar i Këshillit të ASHMA-së, Selver Ajdini zëvendës kryetar i Këshillit të ASHMA-së, mr. Alma Mashoviq, dr. Metodija Jançeski, L Lazar Trajçev, Zoran Fidanoski.

**Anëtarët në mungesë të Këshillit të Agjencisë: /**

**Në seancë nëpërmjet lidhjes video-konferencë ishte i pranishëm dhe dr. Zoran Trajçevski, drejtor i Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuale.**

**Të pranishëm nga Shërbimi Profesional nëpërmjet lidhjes video-konferencë:** mr. Dragica Ljubevska, Goran Radunoviq, Maja Damevska, mr. Ruzhica Boshnakoska Jotevska, dr. Ivana Stojanovska.

**Të pranishmit e tjerë:/**

Z. Petrushevski hapi seancën e 13-të të Këshillit të Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuale. Seanca filloi në ora 14:30 dhe u mbajt nëpërmjet lidhjes video-konferencë.

Këshilli i Agjencisë njëzëri me 6 vota "pro", miratoi:

**RENDIN E DITËS**

1. Miratimi i Propozim-procesverbalit nga seanca e 12-të e Këshillit të Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuale, mbajtur më 26.03.2024.
2. Miratimi i Propozim-procesverbalit nga vazhdimi i parë i seancës së 12-të të Këshillit të Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuale, mbajtur më 28.03.2024.
3. Propozim për iniciimin e procedurës për heqjen e lejes të SHTR TELEVISION SONCE SHPKNJP Prilep.
4. Të ndryshme.

**Pika 1**

Këshilli i Agjencisë shqyrtoi dhe njëzëri miratoi Procesverbalin e propozuar nga seanca e 12-të e Këshillit të Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuale, mbajtur më 26.03.2024, me tekstin e propozuar.

**Pika 2**

Këshilli i Agjencisë shqyrtoi Procesverbalin e propozuar nga vazhdimi i parë i seancës së 12-të të Këshillit të Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuele, mbajtur më 28.03.2024.

Z. Trajçev kishte dy vërejtje në lidhje me diskutimin e tij. Ai sugjeroi që në faqen 4 të procesverbalit, në rreshtin e 9-të nga lart, fjala "kryetarët" të korrigohej në "kryetar" dhe në faqen 5, po ashtu rreshti i 9-të, fjalët "ku u ngrit ajo pyetje" të korrigohej në "ku u bisedua për këtë pyetje"

Këshilli i Agjencisë, me korrigjimet teknike të z.Trajçev, njëzëri miratoi Procesverbalin e propozuar nga vazhdimi i parë i seancës së 12-të të Këshillit të Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuele, mbajtur më 28.03.2024, me tekstin e propozuar.

### **Pika 3**

Z. Trajçevski shpjegoi Propozimin për iniciimin e procedurës për heqjen e lejes të SHTR TELEVISION SONCE SHPKNJP Prilep. Ai shpjegoi se këtij transmetuesi afati për pagesën e faturës i ka skaduar të enjten e kaluar dhe ditën e nesërme të premtën është bërë Raporti me shkrim për mbikëqyrjen e kryer administrative, ku është konstatuar se kompensimi vjetor për lejen e transmetimit televiziv nuk është paguar. Në pajtim me Ligjin, propozohet fillimi i procedurës për heqjen e lejes me një afat shtesë për pagesë prej 15 ditësh. Raporti u çertifikua të premtën, që do të thotë se që atëherë kanë filluar të rrjedhin 15 ditët. Nëse nuk paguhet kompensimi në afat që skadon të premtën e ardhshme, do t'i hiqet leja. Ai bën të ditur se ka pasur një takim joformal me avokatin e kësaj shoqërie tregtare radiodifuzive dhe i është treguar se nuk është paguar kompensimi dhe se mund t'i hiqet leja. Ditën e djeshme avokati ka dërguar një SMS ku shkruhet se nuk sheh asnjë arsye pse nuk mund t'i jepet një afat më i gjatë për të paguar kompensimin (dëmshpërblimin). Ai ka shpjeguar se nuk i është përgjigjur mesazhit sepse nuk ka mundësi ligjore përveç këtyre 15 ditëve shtesë të parapara me Ligj dhe këtë e thotë si informatë që Këshilli të informohet.

Z. Petrushevski tha se Agjencia ka pranuar shkresë drejtuar Këshillit nga TV Sonce në të cilën thuhet se pronari i televizionit është në SHBA dhe nuk mund ta kryej pagesën. Ai ka shpjeguar se kërkesa për shtyrjen e pagesës nuk mund të pranohet sepse duhet vepruar në pajtim me Ligjin. Këshilli, në këtë rast nuk ka zgjidhje tjetër dhe gjithmonë vepron në mënyrë të barabartë për të gjitha mediat.

Z. Fidanoski tha se e ka lexuar shkresën e dërguar nga TV Sonce. Ai shpjegoi se një përfaqësues i televizionit të cilin e njeh personalisht i ka telefonuar dhe i ka shpjeguar pse nuk ka mundur që transmetuesi të bëjë pagesën. Disa informacione përkojnë me shkresën se pronari i televizionit, i cili është shtetas i SHBA-së, në muajin mars ka pasur shuma të mëdha taksash për të paguar dhe se autoritetet tatimore amerikane nuk lejojnë transferimin e mjeteve (fondeve) para se ai të përfundojë detyrimet e tij tatimore atje, dhe për këtë arsye ka vonesë të pagesës së kompensimit vjetor.

Këshilli i Agjencisë njëzëri ka nisur procedurën për heqjen e lejes për transmetim televiziv të Shoqërisë Tregtare Radiodifuzive TELEVISION SONCE SHPKNJP Prilep, PA1 nr.08-141 datë 18.03.2019, për shkak të mospërmbushjes së detyrimit nga neni 80 paragrafi. 5 të Ligjit për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuele, përkatësisht nuk ka paguar kompensimin vjetor për lejen e transmetimit televiziv Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuele sipas faturës së dorëzuar nr 2024-100-0090 datë 26.02.2024.

Nëse transmetuesi i lartpërmendur nuk e paguan kompensimin vjetor për lejen për transmetim televiziv, Këshilli i Agjencisë në afat prej 15 ditësh nga dita e pranimi të Propozimit për ngritjen e procedurës për heqjen e lejes, do miraton Vendim për heqjen e lejes për transmetim televiziv të Shoqërisë Tregtare Riodifuzive TELEVISION SONCE SHPKNJP Prilep, PA1 nr.08-141, datë 18.03.2019, për shkelje të nenit 80 paragrafit 5 të LSHMAAV.

Z. Petrushevski iu drejtua Shërbimit dhe tha saktë që ta informojnë transmetuesin se kur është afati i fundit i pagesës, në mënyrë që të bëjnë përpjekje plotësuese dhe të paguajnë kompensimin.

#### **Pika 4**

#### **Të ndryshme**

Nuk ka pasur diskutim nën Të ndryshme.

**Agjencia për Shërbime Mediatike  
Audio dhe Audiovizuale  
Kryetari i Këshillit,  
Lazo PETRUSHEVSKI, d.v.**